



Festa e Bajramit – Çështje të ndryshme

الحمد لله و صلى الله و سلم على نبينا محمد. أما بعد

■ GJYKIMI I NAMAZIT TË BAJRAMIT

Ka mospajtim ndërmjet dijetarëve në lidhje me gjykimin e Namazit të Bajramit.

- Një pjesë e dijetarëve, prej tyre shumica e medhhebit Hanbeli, një pjesë e medhhebit Hanefi dhe Shafii thonë: *“Është obligim Kifaje (dmth: e kanë detyrë vetëm disa. Nëse e falin një pjesë, bie obligimi nga të tjerët).”*
- Një pjesë e dijetarëve thonë: *“Namazi i Bajramit është obligim për çdo musliman që ka arritur moshën e pubertetit.”*
- Ndërsa, shumica e dijetarëve thonë: *“Namazi i Bajramit është sunnet i fortë, nuk është obligim.”* Ky është mendimi i Malikive, i Shafive dhe i disa hanefive.

Mendimi më i saktë është mendimi i atyre që thonë:

“Namazi i Bajramit është obligim për çdo musliman që ka arritur moshën e pubertetit.”

Ky është mendimi i Hanefive, i disa Malikive, i Ibn Tejmijes, Ibnul Kajjimit, San'aanit, Sheukaanit, Albanit, Bin Bazit, Ibn Uthejmin.

● Edhe gratë e kanë obligim faljen e Bajramit.

Thotë shejh Albani All-llahu e mëshiroftë:

“Çdo femër muslimane që ka arritur moshën e pubertetit e ka obligim faljen e namazit të Bajramit.”

Thotë Umm Atijeh:

((Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem i ka urdhëruar gratë, ato që kanë arritur moshën e pubertetit dhe ato të cilat qëndrojnë në shtëpia (pasi kanë arritur kohën për martesë), të dalin në dy Bajramet))

[Muslimi, Buhariu]

Thonë këta dijetarë:

“Urdhëri i Profetit që të dalin edhe gratë, tregon se Namazi i Bajramit është obligim për çdo musliman i cili ka arritur moshën e pubertetit.”

■ FALJA E BAJRAMIT NË MUSALA

Bajrami është sunnet të falet ne musal-la (vend i hapur). Nuk është mirë të falet në xhami, madje disa dijetarë si Imam Malik e konsiderojnë bidat faljen në xhami, përpos për nevojë.

[Ibn el Haxh]

- **Duhet të kemi kujdes që mos të ketë statuja në sheshet dhe vendet e hapura ku falemi.**

Shejkh Albani thotë:

“Nuk lejohet falja në ato vende të mbyllura si fusha futbollli, nëse ka figura, ose statuja, në ç’farëdo ane qofshin ato, para, mbrapa apo anash.”

Nese falet në shesh të hapur, nëse ka statuja nga para dhe statuja është afër safeve, kjo nuk bën.

Nëse statuja ndodhet larg dhe ka ndarje ndërmjet, nuk ka problem insha All-llahu.

Nëse ndodhet mbrapa safeve, insha All-llahu shpresojmë mos të ketë problem.

- Nëse ka arsye si shiu, bora apo i ftohti i madh, në këto raste lejohet falja e Bajramit në xhami.

■ GUSLI

Pëlqehet marrja gusël për faljen e Namazit të Bajramit.

Imam Neueuiu thotë se ka unanimitet.

■ VESHJA E RROBAVE TË REJA, OSE TË PASTRA PËR FALJEN E NAMAZIT TË BAJRAMIT

Pëlqehet veshja e rrobave te reja, ose të pastra.

Shumë prej selefëve e kanë pëlqyer këtë, prej tyre Ibn Umeri.

■ NGRËNJIA E DISA HURMAVE PARA SE TË DALESH PËR NAMAZIN E BAJRAMIT

Pëlqehet të hash disa hurma para se te dalësh nga shtëpia për të falur Namazin e Bajramit.

Pëlqehet të jenë numër tek: 3 kokrra, ose 5, ose 7, ose 9 etj.

[ALBANI UTHEJMINI etj.]

■ TEKBIRET NË DITËN E BAJRAMIT

Pëlqehet bërja e Tekbireve në Bajramin e Fitrit.

Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.

Disa mendojnë se ka unanimitet.

Thuhet se Seid bin Musejeb dhe Urwetu Ibn Zubejr prej Tabiinëve kanë thënë se Tekbiret e Fitër Bajramit janë obligim.

[E përmend këtë imam Neueuiju në El Mexhmu]

● KOHA E TEKBIREVE

Ka mospajtim ndërmjet dijetarëve në lidhje me kohën e Tekbireve të Bajramit.

Shumica e dijetarëve thonë:

“Koha e fillimit të Tekbireve të Bajramit është pas perëndimit të diellit të ditës së fundit të Ramazanit, dhe fillimit të natës së Bajramit.”

Ky është mendimi i Ibn Tejmijes, i Bin Bazit, Ibn Utthejminit etj.

Një pjesë e dijetarëve thonë:

“Tekbiret e Fitër Bajramit fillojnë prej kur del nga shtëpia për të falur namazin e Bajramit dhe deri sa të vije imami për të falur namazin e Bajramit.”

Është transmetuar nga Ibn Umeri I cili kur dilte për të falur namazin e Bajramit bënte Tekbire derisa të vinte imami për të falur Namazin e Bajramit.

Ky është mendimi i Imam Malik.

Shejh Albani thotë:

“Tekbiret fillojnë pas namazit të sabahut të ditës së Bajramit. Pëlqehet që kur të dale personi për të falur Namazin e Bajramit të bëjë Tekbire derisa të vije imami për të falur Namazin e Bajramit.”

Unë personalisht anoj te ky mendim.

Megjithatë duke qenë se nuk ka argument të prerë, çështja është e gjerë.

Kush dëshiron ia nis që pasi të perëndoje dielli në natën e Bajramit e deri në namazin e Bajramit.

Kush të dojë ia nis prej kur të fale namazin e Sabahut, ose kur të dale për të falur namazin e Bajramit, e derisa të vije imami për të falur namazin e Bajramit.

■ TEKBIRET NË NAMAZIN E BAJRAMIT

Tekbiret shtesë në namazin e Bajramit janë sunnet, nuk janë obligim. Nëse nuk i thua, namazi është i saktë.

[Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve]

● Sa është numri i tyre?

Ka mospajtim:

- Disa thonë janë 7 (shtatë) tekbire bashkë me tekbirin fillestar në rekatën e parë. Dhe 5 tekbire në rekatën e dytë.
- Disa thonë thuhën 7 (shtatë) tekbire, pa tekbirin fillestar. Dhe 5 tekbire në rekatën e dytë pa tekbirin e zhvendosjes. Ky është mendimi i shejh Albanit etj.

● Kur thuhën?

Ato thuhën para leximit të sures el Fatiha në rekatën e parë, po ashtu edhe në rekatën e dytë thuhën para leximit të sures el Fatiha.

[Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve]

Thënia e tyre në rekatën e dytë pas leximit të Kur'anit dhe para rukusë është gabim.

● A ngrihen duart kur i themi këto tekbire?

Ka mospajtim ndërmjet dijetarëve në lidhje me ngritjen e duarve kur i themi këto tekbire:

- Shumica dijetarëve thonë: *“Pëlqehet ngritja e duarve kur i themi këto tekbire.”*
- Një pjesë e dijetarëve, prej tyre Shejh Albani thonë: *“Nuk ka argument që tregon se ngrihen duart në këto tekbire.”*

Më i saktë është mendimi i pakicës së dijetarëve që thonë se nuk ngrihen duart, pasi nuk ka argument.

Ndërsa i përket mendimit të shumicës, ata argumentohen duke u bazuar në hadithet që tregojnë për ngritjen e duarve në namazet tjera.

Ky argumentim i tyre nuk qëndron.

■ KTHIMI NË SHTËPI PAS FALJES SË NAMAZIT TË BAJRAMIT

Pëlqehet që kur të kthehesh pas namazit ,të marrësh rrugë tjetër nga ajo që ke shkuar për në Musal-la.

■ URIMI ME RASTIN E BAJRAMIT

Lejohet urimi për festën e Bajramit.

T'ia urosh tjetrit Bajramin dhe të lutesh që All-llahu t'ia pranoje veprat e mira, duke thënë:

TEKAB-BELALL-LLAHU MINNA UE MINKUM SALIHAL EA'MAL

(Kuptimi: All-llahu i pranofte prej nesh dhe prej jush punët e mira)

Shumë dijetarë, prej tyre shejh Albani, thonë:

“Urimi nuk bëhet para namazit të Bajramit, por pasi të falet Namazi i Bajramit.”

■ VIZITAT ME RASTIN E BAJRAMIT

Sa u përket vizitave të njëri-tjetrit për Bajram, nuk ka argument që vërteton se e kanë bërë të parët tanë.

■ VIZITA E VARREVE PËR BAJRAM

Sa i përket vizitës së varrezave në ditën e Bajramit, siç e veprojnë shumë njerëz, kjo nuk lejohet.

Vizita e varreve ditën e Bajramit me pretendimin se është mirë të vizitohen varret ditën e Bajramit, është bidat. Nuk lejohet!

■ ZBUKURIMI I XHAMIVE APO I SHTËPIVE ME RASTIN E FESTËS SË BAJRAMIT

Zbukurimi i xhamive me rastin e festës së Bajramit, padyshim që konsiderohet bidat dhe përngjasim me jobesimtarët. Dhe në të njejtën kohë është Israf (shpërdorim) siç thonë shejkh Albani, Ibn Uttejmini e shumë të tjerë prej dijetarëve.

Po ashtu edhe zbukurimi i shtëpiave konsiderohet përngjasim me jobesimtarët, dhe është Israf (shpërdorim i pasurisë), dhe si i tillë nuk lejohet.

■ ATIJ TË CILIT I IKËN NAMAZI I BAJRAMIT ME ARSYE?

Shumica e dijetarëve, prej tyre Malikitë, Shafiitë, dhe Hanbelitë thonë:

"Atij të cilit i ikën namazi i Bajramit me njerëzit, është e pëlqyer për të, që t'a fale atë."

Shejh Bin Bazi thotë:

"Nëse jemi me mendimin se namazi i Bajramit është obligim, në këtë rast atij që i ikën namazi i Bajramit me xhemat, e ka detyrë t'a fale atë."

E nëse jemi me mendimin se është i pëlqyer, atëherë është e pëlqyer për të që t'a fale vetëm kur nuk e kap dot me njerëzit."

Shejh Feuzani thotë:

"E fal namazin vetëm, sipas formës siç falet me imam."

Disa dijetarë, prej tyre Hanefitë dhe Ibn Tejmije thonë:

"Nëse të ikën namazi i Bajramit me xhemat nuk falet më (as vetëm dhe as me xhemat). Kjo sepse nuk ka argument që tregon se duhet falur."

Ibn Uttejmini thotë:

"Më e përafërta është se nuk falet më, nëse i ikën me xhemat, me njerëzit."

Shekh Albani thotë:

"Transmetimet që kanë ardhur nga të parët tanë të mirë janë të ndryshme."

Prej tyre ka që thonë se e fal 4 rekate.

Prej tyre ka që thonë se e fal 2 rekate.

Prej tyre ka që thonë se e fal vetëm.

Prej tyre ka që thonë se e fal me xhemat.

Nëse i mundesohet me e fal me ndonjë grup, me xhemat, le t'a fale 2 rekate. E nëse e fal vetëm, le t'a fale 4 rekate."

Thotë shejkh Albani në një vend tjetër:

الصواب تُقضى كما فاتت، هذه قاعدة فقهية أخذت من بعض المفردات من السنة النبوية، والصلاة تُقضى كما فاتت، فصلاة العيد ركعتان فمن فاتته بعد شرعي صلاها ركعتين كما يصلها الإمام، أما صلاة أربع زائد ولا نجد له ما يشهد له من السنة .

سلسلة الهدى والنور شريط 376

"Më e sakta është se ai falet ashtu siç i ka kaluar. Ky është rregull në fikh."

(dmth: nëse namazi është dy rekate, atëherë e fal dy rekate. E nëse është katër rekate, e fal katër rekate)

Namaz i Bajramit është dy rekate, kështu që kush e humb atë për një arsye të pranuar fetare, ai e fal atë dy rekate, ashtu siç e fal imami.

Ndërsa mendimi se falet katër rekate nuk ka ndonjë argument që e mbështet nga suneti."

[Silsilet el-Huda uen-Nur, kasete nr. 376]

Mendimi më i përafërt është se e fal dy rekate, si atëherë kur e fal vetëm, ashtu edhe me xhemat. E fal siç falet me imamin. Edhe tekbiret shtesë i bën njëjtë sikur me imamin.

E njëjta gjë edhe për gratë. Dhe kjo duke u bazuar në rregullin e fikhut të lartpërmendur.

- Ndërsa atij që i ikën pa arsye nuk e fal, por është detyrë për të pendimi. [Albani]

■ KOHA E NAMAZIT TË BAJRAMIT

Sa i përket faljes së namazit të Bajramit para lindjes së diellit, ose gjatë lindjes së diellit, kjo nuk lejohet.

Thotë Ibn Battal:

"Kanë rënë dakord dijetarët se namazi i Bajramit nuk falet para lindjes së diellit, apo gjatë lindjes së diellit."

Ndërsa sa i përket faljes së Bajramit pas lindjes së diellit ka mospajtim ndërmjet dijetarëve.

1) Shumica e dijetarëve (Hanefitë, Malikitë dhe Hanbelitë) thonë:

"Koha e namazit të Bajramit fillon kur të ngrihet dielli një shtizë (përafërsisht 15-20 minuta) sipas shikimit me sy të lirë, e deri në fillim të Zeualit (Zeuali është koha kur dielli është në mes)."

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

إذا طلع حاجب الشمس فدعوا الصلاة حتى تبرز ، و إذا غاب حاجب الشمس فدعوا الصلاة حتى تغيب ، و لا تَحَيَّنُوا بِصَلَاتِكُمْ طُلُوعِ الشَّمْسِ و لا غروبها فإنما تطلع بين قرني الشيطان

((Nëse del skaji (cepi, pjesa e sipërme) e diellit, mos u falni derisa të ngrihet plotësisht. Dhe kur të fillojë të perëndojë skaji i diellit, lëreni namazin derisa të perëndojë krejtësisht. Mos synoni të faleni pikërisht në kohën e lindjes apo të perëndimit të diellit, sepse ai lind mes dy brirëve të shejtanit.))

[Buhariu Muslimi]

Thotë Ukbetu Bin Aamir - radijall-llahu anhu-

ثلاث ساعات كان رسول الله صلى الله عليه وسلم ينهانا أن نصلي فيهن أو نقبر فيهن موتانا :حين تطلع الشمس بازغة حتى ترتفع ((I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem na ndalonte të falemi dhe të varrosim të vdekurit në tre kohë: prej kur dielli fillon të lindë, e derisa të ngrihet plotësisht...))

[Muslimi]

Sa i përket ngritjes së plotë të diellit ka mospajtim:

- Një pjesë e dijetarëve thonë: *"Është për qëllim shfaqja e plotë e diellit."*
- Shumica e dijetarëve thonë: *"Është për qëllim ngritja e tij një shtizë."*

Ndërsa sa i përket ndalesës së përmendur në hadith, shumë dijetarë thonë se ndalesa këtu është për qëllim ndalesa nga falja e namazeve vullnetare të përgjithshme. Ndërsa namazet me sebeb, si: Tehijjatul mesxhid, apo dy rekatet pas abdesit, ose namazi i istikhares lejohet falja e tyre.

Ky është mendimi i disa Sahabëve. Prej tyre Aliu, Aisheh, Ebu Ejjub, Temim Ed-Deerii etj.

[Neueuiju ne El Mexhmu]

Ky është mendimi i Shejkhul Islam Ibn Tejmijes.

Ky është mendimi i Shejkh Albanit, Bin Bazit, Ibn Uthejminit etj.

Pra, mendimi i parë është se fillimi i kohës së namazit të Bajramit është kur të ngrihet dielli një shtizë.

Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.

Ky është mendimi i Shejkh Albanit, Ibn Uthejminit etj.

2) Mendimi i dytë është se fillimi i kohës së namazit të Bajramit është kur lind dielli.

Shafiitë thonë: *“Koha e namazit të Bajramit është prej pasi lind dielli e deri në zeual.”*

Argumenti i shafive në lidhje me këtë është: *“Namazi i Bajramit është namaz me sebeb dhe nuk merren në konsideratë kohët e ndaluara për t’u falur në to namazi.”*

[El Mesuuatu El Fikhijeh (27/243) / Islamqa.info]

Më i sakti është mendimi i shumicës së dijetarëve, që fillimi i kohës së namazit të Bajramit është kur të ngrihet dielli një shtizë.

Ndërsa sa i përket saktësisimit të namazit të Bajramit nëse falet pasi lind dielli pa u ngritur një shtizë, unë nuk mund të them që nuk është i saktë, që nuk pranohet.

Por as nuk them dot që pranohet dhe ska problem.

Argumentimi i Shafiive me faktin se namazi i Bajramit është namaz me sebeb, dhe se ndalesa ka të bëjë vetëm me namazet pa sebeb, qëndron deri diku.

Megjithatë, unë nuk them që pranohet (që është i saktë), por as nuk them që nuk është i saktë (nuk pranohet).

■ FALJA E XHUMASË KUR BIE NË DITË BAJRAMI

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

((قد اجتمع في يومكم هذا عيدان، فمن شاء أجزأه من الجمعة وإنا مُجمعون))

((Në këtë ditë janë bashkuar dy festa...”

(do të thotë: është bashkuar Bajrami me ditën e Xhuma në të njejtën ditë)

Kush dëshiron, i mjafton (falja e Bajramit) nga xhumaja.

(do të thotë: ai që ka falur namazin e Bajramit, lejohet të mos marre pjesë në namazin e xhumasë)

Ndërsa ne do t’a falim xhumanë))

Ka mospajtim në lidhje me atë që fal Bajramin:

A e ka obligim t’a fale të xhumanë kur bie në ditën e Bajramit, apo bie obligimi i faljes së xhumasë?

Shumica e dijetarëve (Hanefitë, Malikitë, dhe Shafiitë) thonë:

“Nuk bie obligimi i të xhumasë. E ka detyrë të prezantoje në namazin e xhumasë.”

Ata argumentohen me faktin se namazi i xhumasë është obligim, All-llahu thotë:

{Kur të thirret ezani për namazin e xhumasë, shpejtoni për te përmendja e All-llahut}

Thonë: Ajeti është i përgjithshëm dhe nuk e ka veçuar rastin kur e xhumaja bie në ditën e Bajramit.

Ky argumentim është shumë i dobët, sepse hadithi i mësipërm është argument i qartë që tregon se obligimi i faljes së xhumasë bie, për atë i cili e fal namazin e Bajramit.

Po ashtu, ata argumentohen me faktin se namazi i Bajramit është i pëlqyer, ndërsa namazi i xhumasë është obligim. E pëlqyera nuk e shfuqizon atë që është obligim.

Ky pretendimin nuk është i saktë, sepse namazi i Bajramit është obligim sipas mendimit më të saktë të dijetarëve.

Madje hadithi i mësipërm na jep të kuptojmë se falja e Bajramit është obligim.

Një pjesë e dijetarëve, prej tyre Hanbelitë thonë:

“Ai i cili e fal Bajramin, nuk e ka obligim të prezantojë në faljen e namazit të xhumasë.”

Thotë Ibn Kudameh:

وإن اتفق عيد في يوم جمعة سقط حضور الجمعة عن صلي العيد إلا الإمام فإنها لا تسقط عنه إلا أن لا يجتمع له من يصلي به الجمعة. وهذا هو المأثور عن النبي -صلى الله عليه وسلم- وأصحابه: كعمر، وعثمان، وابن مسعود، وابن عباس، وابن الزبير، وغيرهم. ولا يعرف عن الصحابة في ذلك خلاف، وأصحاب القولين المتقدمين لم يبلغهم ما في ذلك من السنة عن النبي -صلى الله عليه وسلم- لما اجتمع في يومه عيدان، صلى العيد، ثم رخص في الجمعة، وفي لفظ أنه قال: أيها الناس! إنكم قد أصبتم خيرا، فمن شاء أن يشهد الجمعة فليشهد، فإننا مجمعون، وأيضا فإنه إذا شهد العيد حصل مقصود الاجتماع، ثم إنه يصلي الظهر إذا لم يشهد الجمعة، فتكون الظهر في وقتها، والعيد يحصل مقصود الجمعة. وفي إيجابها على الناس تضييق عليهم، وتكدير لمقصود عيدهم، وما سن لهم من السرور فيه، والانبساط فإذا حبسوا عن ذلك عاد العيد على مقصوده بالإبطال، ولأن يوم الجمعة عيد، ويوم الفطر والنحر عيد، ومن شأن الشارع إذا اجتمع عبادتان من جنس واحد أدخل إحداهما في الأخرى، كما يدخل الوضوء في الغسل، وأحد الغسلين في الآخر. والله أعلم

[El Mugnii]

Thotë Ibn Tejmije All-llahu e mëshiroftë:

الحمد لله، إذا اجتمع الجمعة والعيد في يوم واحد فللعلماء في ذلك ثلاثة أقوال: أحدها: أنه تجب الجمعة على من شهد العيد، كما تجب سائر الجمع للعمومات الدالة على وجوب الجمعة: الثاني: تسقط عن أهل البر، مثل أهل العوالي والشواذ، لأن عثمان بن عفان أرحص لهم في ترك الجمعة لما صلى بهم العيد. والقول الثالث، وهو الصحيح: أن من شهد العيد سقطت عنه الجمعة، لكن على الإمام أن يقيم الجمعة ليشهدها من شاء شهودها، ومن لم يشهد العيد وهذا هو المأثور عن النبي -صلى الله عليه وسلم- وأصحابه: كعمر، وعثمان، وابن مسعود، وابن عباس، وابن الزبير، وغيرهم. ولا يعرف عن الصحابة في ذلك خلاف، وأصحاب القولين المتقدمين لم يبلغهم ما في ذلك من السنة عن النبي -صلى الله عليه وسلم- لما اجتمع في يومه عيدان، صلى العيد، ثم رخص في الجمعة، وفي لفظ أنه قال: أيها الناس! إنكم قد أصبتم خيرا، فمن شاء أن يشهد الجمعة فليشهد، فإننا مجمعون، وأيضا فإنه إذا شهد العيد حصل مقصود الاجتماع، ثم إنه يصلي الظهر إذا لم يشهد الجمعة، فتكون الظهر في وقتها، والعيد يحصل مقصود الجمعة. وفي إيجابها على الناس تضييق عليهم، وتكدير لمقصود عيدهم، وما سن لهم من السرور فيه، والانبساط فإذا حبسوا عن ذلك عاد العيد على مقصوده بالإبطال، ولأن يوم الجمعة عيد، ويوم الفطر والنحر عيد، ومن شأن الشارع إذا اجتمع عبادتان من جنس واحد أدخل إحداهما في الأخرى، كما يدخل الوضوء في الغسل، وأحد الغسلين في الآخر. والله أعلم

"Nëse bashkohen e xhumaja dhe bajrami në një ditë, dijetarët kanë tre mendime rreth kësaj çështjeje:

- *I pari: Namazi i xhumasë është detyrë për atë që e ka falur namazin e bajramit, ashtu siç është detyrë çdo xhuma tjetër, duke u mbështetur në argumentet e përgjithshme që tregojnë obligueshmërinë e xhumasë.*
- *I dyti: E xhumaja bie për banorët e zonave të largëta (si fshatarët dhe ata që jetojnë larg qytetit), sepse Uthman ibn Affan ua lejoi atyre të mos marrin pjesë në xhuma pasi kishte falur me ta Bajramin.*
- *I treti (mendimi më i saktë): Kush e fal namazin e bajramit, i bie detyrimi i xhumasë. Por imami duhet t'a fale të xhumanë në mënyrë që të marrin pjesë ata që dëshirojnë dhe ata që nuk e kanë falur bajramin. Ky mendim transmetohet nga Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem dhe*

nga shokët e tij si: Umeri, Uthmani, Abdull-llah ibn Mes'ud, Abdull-llah ibn Abbas, Abdull-llah ibn Zubejr dhe të tjerë. Dhe nuk dihet që sahabët të kenë pasur kundërshtim në këtë çështje.

Ndërsa sa i përket dy mendimeve të para, atyre nuk iu ka arritur sunneti i Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem për këtë çështje:

((Kur në një ditë u bashkuan dy festa, ai fali namazin e bajramit dhe më pas dha leje për xhumanë))

Ndërsa në një transmetim tjetër thotë:

((O njerëz! Ju ja keni qëlluar mirësisë (dmth: e falët Bajramin). Kush dëshiron të marre pjesë në faljen e xhumasë, le të marre pjesë. Ne do ta falim))

Gjithashtu (tjetër argument që tregon se bie obligimi i xhumasë për atë që fal Bajramin, është fakti se) kur falet bajrami, arrihet qëllimi i tubimit.

... Kështu, bajrami përmbush një pjesë të qëllimit të xhumasë.

Bërja obligim e të xhumasë në këtë rast do të ishte vështirësim për njerëzit dhe do t'ua zbehte gëzimin e bajramit dhe qëllimin e tij të lumturisë dhe kënaqësisë. Nëse njerëzit do pengohen (privohen) nga kjo, atëherë prishet qëllimi i bajramit.

Po ashtu, dita e xhumasë është feste dhe dita e Fitër Bajramit dhe Kurban Bajramit janë festa.

Nga urtësia e Sheriatit është që kur bashkohen dy adhurime të të njëjtit lloj, njëra përfshihet në tjetrën (dmth: futet njëra te tjetra), siç futet (hyn) abdesi në gusl, ose një gusël (larje) në tjetrën.

Allahu e di më së miri."

[Mexhmu el Fetawa]

Thotë Bin Bazi All-llahu e mëshiroftë:

و إذا وافق العيد يوم الجمعة جاز لمن حضر العيد أن يصلي الجمعة و أن يصلي ظهرا فقد ثبت عنه صلى الله عليه وسلم أنه رخص في الجمعة لمن حضر العيد، و قال ((اجتمع في يومكم هذا عيدان، فمن شهد العيد فلا جمعة عليه))، و لكن لا يضيع صلاة الظهر، و الأفضل أن يصلي مع الناس جمعة "

"Nëse festa e Bajramit përkon me ditën e xhumasë, lejohet për atë që e ka falur namazin e Bajramit që të zgjedhë:

- Ose të fale xhumanë.
- Ose të fale drekën.

Kjo duke u bazuar në atë që është vërtetuar nga Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem se ai ia ka lejuar atij që fal Bajramin të mos e fale të xhumanë.

Ka thënë:

((Janë bashkuar në këtë ditë tuajën dy festa; kush e ka falur Bajramin, nuk e ka obligim xhumanë))

Por, mos ta lerë namazin e drekës.

Dhe më e mira është që të falë të xhumanë bashkë me njerëzit"

Ibn Uttejmini (All-llahu e mëshiroftë) thotë:

"فمن حضر العيد سقطت عنه حضور الجمعة"

"Kush e fal Bajramin i bie obligimi i prezantimit në namazin e xhumasë."

U pyet shejh Albani All-llahu e mëshiroftë:

صلاة الجمعة إذا جاءت في يوم عيد، هل تسقط كلياً، يعني يرخص بأن لا يصلبها المسلم؟

Nëse e xhumaja bie në ditën e Bajramit, a bie obligimi i të xhumasë? A i lejohet muslimanit që mos t'a fale të xhumanë?

U përgjigj shejhu :

نعم...

و الذين يصلون العيد فهم بالخيار, من شاء ترك و من شاء صلى.

"Po... ata që falin Bajramin u lejohet të zgjedhin: kush të doje mos t'a fale xhumanë, kush të doje t'a fale."

Nuk ka dyshim se ky mendim është mendimi i saktë, sepse argumenti për këtë është i qartë.

Ndërsa ata që thonë të kundërtën, nuk kanë argument, përpos argumente të përgjithshme.

● DISA E KUSHTËZOJNË QË TË DËGJOSH HUTBEN E BAJRAMIT NËSE NUK DO TË FALËSH TË XHUMANË

Thonë: *"Duhet t'a dëgjosh hutben e Bajramit nëse do që të mos e falësh të xhumanë."*

Me pretendimin e tyre se hutbeja e Bajramit e zëvendëson hutben e xhumasë.

Unë nuk di se ku e kanë marrë këtë fjalë.

Kam dëgjuar disa fetwa të Bin Bazit, Ibn Uttejmit, kam dëgjuar atë që thotë shejh Albani, kam lexuar fjalët e disa prej atyre që e lejojnë mosfaljen e xhumasë në rastin kur e fal Bajramin, ama asnjëri nuk e ka përmendur këtë kusht.

Pastaj nëse është dikush që e ka përmendur, ku e ka argumentin për këtë.

Ai që e thotë këtë, duhet të sjellë argument.

Nëse nuk ka argument, nuk i lejohet të flase.

All-llahu e di më së miri.

● NDËRSA SA I PËRKET FALJES SË DREKËS

Shumica dërrmuese e dijetarëve thonë:

"Duhet falur namazi i drekës."

Një pjesë e dijetarëve, prej tyre shejkh Albani thonë:

"Nëse e fal Bajramin, dhe nuk dëshiron t'a falësh të xhumanë, nuk e fal as drekën."

Në lidhje me këtë, ndoshta do flas herë tjera - insha All-llahu -

Personalisht i përmbahem mendimit të shumicës.

Nuk shikoj ndonjë argument të qartë në lidhje me këtë.
Megjithatë ka nevojë për studim më të thellë.

● A ËSHTË MË MIRË ME E FAL TË XHUMANË APO JO?

Shumë dijetarë thonë:

“Është më mirë me e fal të xhumanë.”

Fjala e mësipërme e Ibn Tejmijes jep të kuptohet se mosfalja e xhumasë vjen si shkak i mos mundimit të besimtarit në këtë ditë, në mënyrë që t’a përjetoje të plotë kënaqësinë e kësaj feste.

E nëse është kështu, atëherë kjo varet te personi.

Nëse një person ka angazhime me familjen, dhe nëse falja e xhumasë e pengon, ndoshta në këtë rast është më mirë mos të shkoje t’a fale.

T’a veproje këtë duke patur parasysh hadithin e Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ku thotë:

((All-llahu do që rob i t’i marre (veproje) RUKHSAT e Tij, ashtu siç do që ai t’i veproje obligimet e Tij))*

*Rukhsa është leja për mos t’a vepruar një obligim, në formë lehtësimi për një kohë të caktuar, siç është rasti i mosfaljes së xhumasë në rastin konkret.

Apo duke e zëvendësuar me diçka më të lehtë, siç është rasti i kompensimit të agjërimit me ushqim për atë që nuk mundet etj.

All-llahu e di më së miri

Ai është më i Dijshmi

و الحمد لله رب العالمين

و صلى الله على نبيينا محمد وعلى آله و صحبه و سلم